

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. nr. 24/09

10 qershor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, me Trupin Gjykes të përbërë nga Gjykatësi nga EULEX Hajnalka Veronika Karpati në cilësinë e Kryetarit të Trupit Gjykes, dhe Gjykatësve nga EULEX Charles Smith dhe Klaus Jung si anëtarë të Trupit Gjykes, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtorit Profesional nga EULEX Noora Aarnio si Proces-Mbajtëse në lëndën penale kundër;

Hajriz GASHI, të akuzuar me aktakuzën e ngritur nga Prokurori, shënuar me PP. nr. 104/08 të datuar dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 10 mars 2009, konfirmuar gjatë seancës për konfirmim të aktakuzës më 11 janar 2010, dhe të ndryshuar gjatë shqyrtimit kryesor më 29 prill, me veprat penale si në vijim;

- **vrasje**, në pajtim me Nenin 146, KPK,
- **vrasje në tentativë**, në pajtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 20, KPK dhe
- **Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 1, KPK,

Shaqir GASHI, të akuzuar me aktakuzën e ngritur nga Prokurori, shënuar me PP. nr. 104/08 të datuar dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 10 mars 2009, konfirmuar gjatë seancës për konfirmim të aktakuzës më 11 janar 2010, dhe të ndryshuar gjatë shqyrtimit kryesor më 29 prill, me veprat penale si në vijim;

- **Nxitje në kryerjen e vrasjes**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 24, KPK,
- **Nxitje në kryerjen e vrasjes në tentativë**, në 3 kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 20 dhe 24, KPK dhe
- **Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 1, KPK,

Kasum GASHI, të akuzuar me aktakuzën e ngritur nga Prokurori, shënuar me PP. nr. 104/08 të datuar dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë më 10 mars 2009, me veprat penale si në vijim;



Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 1, KPK dhe

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me dyer të hapura më 30, 31 mars, 27, 29 prill, 31 maj dhe 10 qershor, që të gjitha në praninë e të akuzuarit Hajriz Gashi, Shaqir Gashi dhe Kasum Gashi, avokatëve të tyre mbrojtës Adem Vokshi, Zeqir Maxhuni dhe Arif Hasi, pala e dëmtuar Jonuz Gashi, Përfaqësuesi Ligjor i Palës së Dëmtuar Fadil Hoxha dhe Prokurori Publik nga EULEX Neeta Amin, pas shqyrtimit të lëmdës dhe votimit nga ana e Trupit Gjyqësor më 10 qershor 2010, në pajtim me Nenin 392, paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) është bërë e ditur që ditën e njëjtë dhe në praninë e të gjithë të akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës, palës së dëmtuar, përfaqësuesit të tij ligjor dhe Prokurorit Publik nga EULEX, si në vijim

VENDIM ¹

I akuzuari **Hajriz GASHI**, pa pседonim, i biri i Shaqir Gashit dhe Nuriye Rexhepit, i lindur më 12 qershor 1988 në fshatin Kryshevc, komuna e Skenderaj, Kosovë, i kombësisë shqiptare of Albanian, banor i fshatit Kryshevc, komuna e Skenderaj, beqar, jeton me prindërit, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, pa dosje penale, në paraburgim që nga 20 shtatori 2008 deri më 11 janar 2010, i është nënshtruar masës së sigurimit të raportimit në stacion të policisë dhe ndalimit të ofrimit personave të caktuar

Me kaq

SHPALLET FAJTOR

- **Për shkak se** më 20 shtator 2008 rreth orës 13:00 në lagjen “Gashi”, në fshatin Kryshevc, komuna e Skenderaj me armën automatike AK 47 të kalibrit 7,62x39mm me numrin serik C-43367 shtiu 10 plumba në drejtim të Abedin Gashit dhe Kasum Gashit, duke qëlluar secilin prej tyre me nga një plumb dhe duke shkaktuar vdekjen e menjëhershme të Abedin Gashit dhe lëndime të rënda trupore Kasum Gashit në dorën e djathtë.

Me të bërë një gjë të tillë, i akuzuari Hajriz Gashi ka kryer dhe do të mbahet penalisht përgjegjës për veprën penale

¹ Në verzionin shqip është shkruar vendim në vend të aktgjykim



Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 2, KPK, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK).

I akuzuari **Hajriz GASHI**

Me kaq

SHPALLET I PAFAJSHËM

- **Për shkak** se nuk është përjashtuar mundësia të ketë vepruar në mbrojtje të nevojshme në pajtim me Nenin 8, paragrafi (2), KPPK kur më 20 shtator 2008 rreth orës 13:00 në lagjën “Gashi”, fshati Kryshevc, komuna e Skenderaj, me armën automatike AK 47, të kalibrit 7,62x39mm me numrin serik C-43367 shtiu 10 plumba në drejtim të Abedin Gashit dhe Kasum Gashit, duke qëlluar secilin prej tyre me një plumb dhe në këtë mënyrë duke shkaktuar vdekjen e menjëhershme të Abedin Gashit dhe lëndime të rënda trupore Kasum Gashit në dorën e djathtë.

Prandaj, në pajtim me Nenin 390, pika 3), Kodi i Procedurës Penale të Kosoës, i akuzuari Hajriz Gashi **lirohet** nga pika e akuzës për

Vrasje, në pajtim me Nenin 146, KPK, dhe **vrasje në tentativë**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 20, KPK.

I akuzuari **Shaqir GASHI**, pseudonimi, i biri i Hajriz Gashit dhe Mehmere Shalës, i lindur më 21 gusht 1960 në fshatin Kryshevc, komuna e Skenderaj, Kosovë, i kombësisë shqiptare, banor i fshatit Kryshevc, komuna e Skenderaj, i martuar, baba i 7 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, pa dosje penale, në paraburgim që nga 20 shtatori 2008 deri më 11 janar 2010, dhe pastaj i është nënshtruar masës së sigurisë të raportimit në polici dhe ndalimit për t'u afruar personave të caktuar

Me kaq

SHPALLET I PAFAJSHËM



- **Për shkak se** nuk është vërtetuar se më 20 shtator 2008 rreth orës 13:00, në lagjen “Gashi”, fshati Kryshevc, komuna e Skenderaj, ka nxitur të birin Hajriz Gashi të shtijë me armën automatike AK 47, të kalibrit 7,62x39mm, me numrin serik C-43367 drejt Abedin Gashit dhe Kasum Gashit. As nuk është vërtetuar se ky kishte dijeni mbi armën në posedim të të birit dhe se ai vetë ka përdorur atë armë.

Prandaj, në pajtim me Nenin 390, pika 3), KPPK, i akuzuari Shaqir Gashi lirohet nga pika e akuzës

Nxitje në vrasje, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 24, KPK, nxitje në kryerjen e vrasjes në tentativë, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 20 dhe 24, KPK dhe Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 1, KPK.

I akuzuari **Kasum GASHI**, pa pseudonim, i biri i Jonuz Gashit dhe Hava Jasharit, i lindur më 9 prill 1978 në fshatin Kryshevc, komuna e Skenderaj, Kosovë, i kombësisë shqiptare, banor i fshatit Kryshevc, komuna e Skenderaj, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, të ardhura mujore prej 400 Euros, pa dosje penale,

Me kaq

SHPALLET FAJTOR

- **Për shkak se** më 20 shtator 2008 rreth orës 13:00 në lagjen “Gashi”, fshati Kryshevc, komuna e Skenderaj, me pistoletën Crvena Zastava M-57, të kalibrit 7,62x25 mm, me numrin serik C-139535, ka shtënë tre herë në drejtim të dritares së shtëpisë së Shaqir Gashit.

Me të bërë një gjë të tillë, i akuzuari Kasum Gashi ka kryer dhe mbahet penalisht përgjegjës për veprën penale

Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 2, KPK.

I akuzuari **Açused Hajriz Gashi** me kaq



DËNOHET

- Me 4 /katër vjet burgim për veprën penale Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve

Koha e kaluar në paraburgim që nga 20.9.2008 deri më 11 janar 2010 do të llogaritet në pajtim me Nenin 73, paragrafi (1), KPPK.

I akuzuari **Açused Kasum Gashi** me kaq

DËNOHET

- Me 3 /tre vjet burgim për veprën penale Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve

Arma automatike AK 47 e kalibrit 7,62x39mm me numrin serik C-43367, arma automatike AK-47, kalibri 7,62x39mm, me numrin serik 8402983 dhe pistoleta Crvena Zastava M-57 kalibrit 7,62x25 mm me numrin serik C-139535 me kaq konfiskohen në pajtim me Nenin 60, paragrafi (1) dhe Nenin 328, paragrafi (5), KPPK.

I akuzuari Hajriz Gashi dhe i akuzuari Kasum Gashi do të kompensojnë shpenzimet për procedurën penale në pajtim me Nenin 102, paragrafi (1), KPPK, me përjashtim të shpenzimeve për përkthim. Një vendim i veçant lidhur me shumën e shpenzimeve dfo të nxjerret nga gjyqata kur të pmaohen të dhënat e duhura në pajtim me Nenin 100, paragrafi (2), KPPK.

Në pajtim me Nenin 103, paragrafi (1), KPPK, shpenzimet e procedurës penale në pajtim me Nenin 99, paragrafi (2), nënparagrafi 1 deri më 5, KPPK, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit Shaqir Gashi dhe pagesa dhe shpenzimet për avokatin mbrojtës si dhe shpenzimet për përkthim do të paguhet nga burimet e buxhetit.

ARSYETIMI



A. PRAPAVIJA E PROCEDURËS – AKTAKUZA

Më 10 mars 2009, Prokurori Publik nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ngriti aktakuzën PP. nr. 104/08 më 10.03.2009 në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

Aktakuza pretendon se i pandehuri Hajriz Gashi kishte kryer veprat penale si në vijim

- **Vrasje e rëndë**, në kundërshtim me Nenin 147, paragrafi (1) dhe nënparagrafi 3, KPK
- **Vrasje e rëndë në tentativë**, në kundërshtim me Nenin 147, paragrafi (1) nënparagrafi 3 lidhur me Nenin 20, KPK

Aktakuza pretendon se i pandehuri Shaqir Gashi kishte kryer veprat penale si në vijim

- **Nxitje në kryerjen e vrasjes së rëndë**, në kundërshtim me Nenin 147, paragrafi (1), nënparagrafi 3 lidhur me Nenin 24, KPK
- **Nxitje në kryerjen e vrasjes së rëndë në tentativë**, në kundërshtim me Nenin 147, paragrafi (1), nënparagrafi 3 lidhur me Nenin 20 dhe 24, KPK

Aktakuza pretendon se i pandehuri Kasum Gashi kishte kryer veprën penale si në vijim

- **Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 1, KPK.

Aktakuza është konfirmuar me vendimin e Gjykatës Konfirmues nga EULEX më 11 janar 2010 me ca ndryshime. Pikat e konfirmuara të akuzës kundër të akuzuarit **Hajriz Gashi** ishin si në vijim

- **Vrasje**, në kundërshtim me Nenin 146, KPK,
- **Vrasje në tentativë**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 20, KPK.

Pikat e konfirmuara të aktakuzës kundër të akuzuarit **Shaqir Gashi** ishin

- **Nxitje në kryerjen e vrasjes**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 24, KPK,
- **Nxitje në kryerjen e vrasjes në tentativë**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 20 dhe 24, KPK dhe

Në lëndën kundër të akuzuarit **Kasum Gashi**, aktakuza që përmbante pikat fillestare është konfirmuar.

Gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur më 27 prill 2010, Prokurori Publik nga EULEX në mënyrë verbale ka ndryshuar aktakuzën duke shtuar pikën e akuzës **Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 1, KPK kundër Shaqir Gashit, duke konfirmuar të njëjtën gjatë seancës së mbajtur më 29 prill 2010 dhe duke shtuar pikën e njëjtë të akuzës kundër Hajriz Gashit në ndryshimin e dytë verbal të aktakuzës.

Gjatë fjalës përfundimtare dhe pa ndryshimin e aktakuzës, Prokurori sugjeroi se provat e prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor shpiejnë drejt ekzistimit të elementeve të duhura për përbërjen e vrasjes së rëndë dhe vrasjes së rëndë në tentativë.



Seancat e shqyrtimit kryesor u mbajtën më 30 dhe 31 mars, 27 dhe 29 prill, 31 maj dhe 10 qershor 2010. Fjalët përfundimtare janë dhënë nga Prokurori nga EULEX Prosecutor Neeta Amin, Pala e Dëmtuar Jonuz Gashi, Përfaqësuesi Ligjor i Palës së Dëmtuar Fadil Hoxha, dhe Avokatët Mbrojtës Adem Vokshi, Zeqir Maxhuni dhe Arif Hasi më 10 qershor 2010. Vendimi është nxjerrë në ditën e njëjtë në mënyrë verbale.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

Në pajtim me Nenin 23, pika 1) i), KPPK, gjykatat e qarkut kanë kompetencën për të trajtuar lëndët penale që kanë të bëjnë akuza për të cilat ligji lejon dënimin penal prej më së paku pesë vjet. Në pajtim me Nenin 27, paragrafi (1), KPPK, juridiksioni territorial qëndron te gjykata në komunën e së cilës pretendohet të jetë kryer vepra penale.

Siç u cek më lart, pika e akuzës për vrasje në pajtim me Nenin 146, lejon sjelljen e vendimit për burgim prej së paku pesë vjet. Për më tepër, në këtë rast, aktakuza pretendon se të akuzuarit kanë kryer veprat penale në Kryshevc, Skenderaj.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është trupi gjyqësor me kompetencë për të trajtuar këtë çështje penale.

Më 18 nëntor 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjykatësve nga EULEX Judges ushtroi të drejtën e saj për të caktuar gjykatësit nga EULEX në lëndët që bien nën kompetencën subsidiare të gjykatësve nga EULEX në pajtim me Nenin 3.3 të "Ligji mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e tyre gjykatësve dhe Prokurorëve nga EULEX në Kosovë" dhe i caktoi këtë lëndë gjykatësve nga EULEX të vendosur në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

C. Përmbledhje e provave të prezantuara

Gjatë shqyrtimit kryesor kanë dëgjuar dëshmitarët si në vijim:

- (1) Jonuz Gashi – palë e dëmtuar, 30 mars 2010
- (2) Rasim Gashi – dëshmitar, 31 mars 2010
- (3) Muje Gashi – dëshmitar, 31 mars 2010
- (4) Jahe Gashi – dëshmitar, 31 mars 2010



- (5) Lumturije Gashi – dëshmitar, 27 prill 2010
- (6) Mirsade Gashi – dëshmitar, 27 prill 2010
- (7) Arsim Gerxhaliu – ekspert dëshmitar, 27 prill 2010

Gjatë shqyrtimit kryesor janë lexuar dokumentet e mëposhtme dhe janë pranuar si prova:

- (8) Raporti Hetues nga Zyrtari i Policisë së Kosovës, i datës 21 shtator 2008
- (9) Faqja vazhduese nr. 1 e Raportit të Policisë, e datës 20 shtator 2008
- (10) Raporti i Zyrtarit të Policisë, i datës 20 shtator 2008
- (11) Raporti mbi Ekzaminimin e Vendngjarjes, i përpiluar më 21 shtator 2008
- (12) Kërkesa për asistim, e datës 22 shtator 2008
- (13) Raporti i Ekzaminimit, i nxjerrë nga Divizioni i Armëve brenda Departamentit të Trazeologjisë në Qendrën për Mjekësi Ligjorë “Ivan Vucetic” në Zagreb, i datës 13 janar 2009
- (14) Skica e vendngjarjes, 08-104/2008-BI-235
- (15) Lista e fotografive nga Ekipi Rajonal për Krim në Mitrovicë, Njësia Rajonale e Forenzikës së bashku me Raportin Identifikues të Mjekësisë Ligjore
- (16) Lista e masave dhe legjenda nga Ekipi Rajonal për Krim në Mitrovicë,
- (17) Raporti i Autopsisë, i datës 22 shtator 2008
- (18) Dokumentacioni mjekësor lidhur me lëndimet që pësoi Kasum Gashi, dorëzuar nga Avokati Mbrojtës Arif Hasi më 12.04.2010.
- (19) Fotografi 123 A-C, dorëzuar nga Prokurori më 29 prill 2010
- (20) 3 fotografi ajrore të lagjës, dorëzuar nga përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar, Fadil Hoxha më 29 prill 2010
- (21) Raporti i Hetuesit nga Policia e Kosovës, Njësia Hetuese, Stacioni i Policisë në Skenderaj, i datës 20.9.2008
- (22) Raporti Identifikues Forenzik nga Ekipi Rajonal për Krim, Forenzika Rajonale, e datës 20.9.2008
- (23) Raporti mbi Ekzaminimin e Krimit nga Departamenti i Policisë së Kosovës – Laboratori për krim, armë dhe gjurmë, ekzaminimi i datës 11.12.2008

Gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur më 29 prill 2010, i akuzuari Hajriz Gashi dha deklaratë dhe u përgjigj në pyetje. Gjatë shqyrtimit kryesor më 31 maj, Shaqir Gashi dha deklaratë dhe u përgjigj në pyetje. Kasum Gashi ushtroi të drejtën e tij për t’u mbrojtur në heshtje.

Pala e dëmtuar Jonuz Gashi deklaroi se i biri Kasum Gashi kishte takuar Shaqir Gashin më herët më 20 shtator 2008 dhe Kasum Gashi e parandaloi Shaqir Gashin që të kalonte përmes tokës së tyre.

Ca minuta para se të bëhej ora një, të bijtë Abedin Gashi dhe Kasum Gashi po mblidhnin arrat në fushë dhe ky ishte në kopsht. Ai dëgjoi 4 apo 5 të shtëna të shkurtëra dhe të shpejta nga arma automatike. Të shtënat erdhën nga shtëpia e fqijut Shaqir Gashi. Jonuz



Gashi filloi të largohej nga kopshti i tij për të parë se çfarë po ndodhte. I biri Kasum Gashi erdhi në kopsht dhe kishte dorën e thyer dhe të gjakosur.

Kasum Gashi i tha Jonuz Gashit se Shaqir Gashi i kishte kontrolluar gjatë rrugës së vetme për t'u kthyer në shtëpi nga fushat e arrave. Këtë nuk e dëgjoi vetë Jonuz Gashi, por sipas Kasum Gashit, Shaqir Gashi i kishte thënë Abedin Gashit të largonte telin e rrymës. Sipas Kasum Gashit, kur Abedin Gashi po i përgjigjej kërkesave Shaqir Gashi i kishte thënë të birit Hajriz Gashi: "Gjuaj! Çfarë po pret?" Kishte qenë qëllimi i tij që të vriste Abedin dhe Kasum Gashin aty. Hajriz Gashi kishte shtënë në ta që nga ballkoni në kat të parë.

Jonuz Gashi dhe Kasum Gashi dolën në rrugë me qëllim të arrinin te Abedin Gashi. Kur u përpoqën të afrohen, Shaqir Gashi shtinte në ta me armë automatike nga ballkoni i katit të parë dhe u thoshte: "Ejani dhe merreni" si dhe "Ejani dhe do të ju gjuaj me bomba sikur të jetë gjëra e fundit që do të bëj." Edhe Hajriz Gashi ishte në ballkon. Plumbat po fluturonin rreth tyre dhe nuk guxonin të afroreshin më shumë. Pas të shtënave të ndërprera 4 apo 5 here për një kohë të shkurtër, Shaqir Gashi u fut brenda dhe ata shkuan tek Abedini. Kur ata së bashku me Rasim Gashin po përpiqeshin të vendosnin Abedin Gashin në veturë, 2 policë që kishin dëgjuar të shënat erdhën në vendngjarje.

I akuzuari Hajriz Gashi deklaroi se më 20 shtator 2008 herët në mëngjes kishte nxjerrë gjënë në fushë. Derisa ishte akoma në fushë, pra rreth prës 11.15 apo 11.20, ai pa të atin, Shaqir Gashin që po vinte me trakton me të motrën dhe të vëllanë. Motra dhe vëllai po qanin dhe i treguan se gjatë rrugës kishin hasur Abedin Gashin dhe Kasum Gashim, të cilët po mbanin armë në duar. Sipas motrës dhe vëllait, Kasum Gashi ishte kërcënuar se do t'u vriste babanë dhe do të vinte në shtëpinë e tyre dhe t'i vriste që të gjithë. Ai pyeti babanë për këtë gjë por ky i fundit i tha "lëre fare se asgjë nuk ndodhi". Rrugës për në shtëpi morën një rrugë më të gjatë për të mos pasur telashe me Abedin Gashin dhe Kasum Gashin.

Pas arritjes në shtëpi dhe shkarkimit të barit të thatë, Hajriz Gashi shkoi në fushë. Para se të nisej, i ati e paralajmëroi "nëse i sheh, mos hap telashe" lidhur me Abedin Gashin dhe Kasum Gashin.

Pas arritjes në shtëpi për herë të dytë, ai shkoi në banjon e katit të parë për të larë duart dhe ndërruar rrobat. Derisa po i lante duar, dëgjoi se i ati Shaqir Gashi në njërin anë dhe Abedin Gashi dhe Kasum Gashi në anën tjetër po bisedonin, por nuk ia doli të kuptonte se çfarë po thonin. Zërat vinin nga poshtë nëpërmjet derës së hapur të ballkonit.

Ai shkoi në dhomën me dritare drejt rrugës dhe pa se Abedin Gashi dhe Kasum Gashi po rinin në rrugë aty ku ka mund të ketë qenë i ati i tij, në ballkonin e katit përdhesë. Të atin nuk e pa. Abedin Gashi ishte më afër, rreth 4 metra nga këndi i ballkonit të katit përdhesë dhe Kasum Gashi ishte prapa, mbase 10 - 12 metra nga këndi i ballkonit të katit përdhesë. Kasum Gashi dhe Abedin Gashi nuk kishin gjë në duar, por pa mbajtësin e një arme të bardhë në anën e majtë të belit të Kasum Gashit. Biseda kishte përfunduar. Kasum Gashi nxorri armën dhe e drejtoi atë me dorën e djathtë te babai i Hajriz Gashit.



At në këto çaste ai u tërhoq nga dritarja. Për shkak të kërcënimeve të mëparshme kishte frikë. Shkoi në dhomën tjetër, hipi mbi karrige, largoi ca drunj nga tavani dhe nxorri armën automatike. Këtë e kishte gjetur dy apo tre vjet më parë. Atëbotë ajo kishte qenë e mbushur. Këtë e kishte fshehur dhe nuk i kishte thënë kujt gjë për shkak se po ta kishte ditur i ati, e kishte marrë armën dhe e kishte dorëzuar.

Ai u kthye në korridor dhe vendosi armën në dysheme. Deri atëherë nuk kishte dëgjuar të shtëna, prandaj mendoi se situata ishte qetësuar. Pastaj shkoi në ballkon për të parë se çfarë po ndodhte dhe shkoi nga këndi. Nuk ia doli të shihte të atin, i cili ishte nën të. Kasum Gashi ishte në vendin e njëjtë ku e kishte parë Hajriz Gashi më parë dhe Abedin Gashi ishte para Kasum Gashit. Sapo e pa Kasum Gashi, iu drejtua duke e sharë 'ku po shkon, nënën...' drejtoi armën tek ai dhe filloi të shtinte dhe të shkonte përreth Abedin Gashit. Kasum Gashi shtiu dy herë dhe pastaj katër apo pesë herë me hapësira ndërmjet. Hajriz Gashi u tërhoq në kënd në mënyrë që të mos vritej. Pastaj dëgjoji zë femre nga kati përdhese duke britur "e vranë, e vranë". Mendoi se i kishin vranë të atin. Më vonë, pa dritaret që ishin thyer.

Shkoi në korridor për të marrë armën dhe pastaj doli në ballkon. Zgjati që të dy duart nga ballkoni për të shtëne. Shtiu në drejtim të Kasum Gashit dhe Abedin Gashit, që ishin rreth 10 metra larg, por nuk ia doli të merrte në shenjë për shkak se edhe Kasum Gashi kishte armë. Hajriz Gashi nuk e paralajmëroi me fjalë Kasum Gashin para se të shtinte. Derisa po shtinte, nuk dëgjoji të shtëna nga armë të tjera.

Nuk kishte për qëllim që të vriste ndokend, por qëllimi i të shtënave nga ai ishte që të frikësonte Kasum Gashin dhe Abedin Gashin dhe t'i bënte që të iknin nga shtëpia në mënyrë që të shpëtonte familja e tij dhe ai vetë. Ky është rritur në vendin e njëjtë me Abedin Gashin dhe edhe pse të shumtën e kohës, Abedin Gashi kishte qenë jashtë vendit, ky e kishte pëlqyer Abedin Gashin.

I gjithë incidenti zgjati rreth 30, 40 apo 50 sekonda, as një minutë. Pas të shtënave, ky u tërhoqë brenda në shtëpi dhe hyri në korridor për të shkuar në katin përdhese. Shkallëve pa babanë Shaqir Gashi, i cili i mori armën ngase ky ishte shumë i frikësuar për ta lëshuar. Hajriz Gashi vazhdoi në dhomën e ndejës ku e ëma, dy motrat e tij më të vogla, vëllai dhe motra që ishin alivanosur, të gjithë po qanin.

Derisa ishte në dhomën e ndejës, pa nga dritarja Rasim Gashin dhe Kasum Gashin në rrugë afër shtëpisë, rreth 70 deri në 80 metra larg dhe po ecnin drejt shtëpisë. Nuk pa Kasum Gashi të ketë pasur ndonjë lëndim. Kasum Gashi kishte armë automatike në dorën e djathtë dhe me të dy duart e mbante drejt shtëpisë. Rasim Gashi kishte diçka në dorë, por Hajriz Gashi nuk e dinte se çfarë. Rasim Gashi po bërtiste me zë të lartë dhe po thoshte "të futemi brenda dhe t'u hedhim një bombë". Këtu, Hajriz Gashi nuk e pa Abedin Gashin. Pastaj dy policët, Jahe Gashi dhe Muje Gashi erdhën me vrap.



Ai nuk e pa trupin e Abedin Gashit, por pa se morën dikë dhe e vendosën në veturë. I ati thirri policinë nga dhoma e ndejës pasi që është marrë marrë trupi. Gjatë gjithë këtij incidenti, ai asnjëherë nuk pa të atin me armë.

I akuzuari Shaqir Gashi deklaroi se deri 3 vjet para lufte, familje e tij kishte pasur marrëdhënie të mira me familjen e Jonuz Gashit. Dy muaj para ditës kritike, Jonuz Gashi dhe Kasum Gashi erdhën para shtëpisë së tij dhe e kërcënuan atë. Kasumi kishte pasur një armë në brez dhe e kishte zbuluar atë. Jonuz Gashi gjithnjë kishte qenë i interesuar për të pasur probleme me ta.

Më 20 shtator 2008, ai pa Kasum Gashin dhe Abedin Gashin duke vrapsur nga shtëpia e tyre dhe nëpërmjet tokës së pflëshme drejt tij. Kasum Gashi po mbante një armë në anën e djathtë. Abedin Gashi kishte një armë dore në anën e djathtë të brezit dhe po e mbante që të mos binte dhe me dorën e majtë po i bënte shenjë që Shaqir Gashi të ndalonte. Ai ndaloi. Abedin Gashi iu afrua traktorit dhe Kasum Gashi qëndroi 2 metra pas tij. Abedin Gashi i tha tre herë “Shaqir, do të të vras.” Shaqir Gashi i tha Abedin Gashit që ta linte të kalonte. Kasum Gashi i tha Abedin Gashit “shkojmë, shohim për të më vonë.” Kasum Gashi iu afrua fëmijëve të Shaqir Gashit dhe u tha diçka. Për shkak të zhurmës së traktorit dhe për shkak se fëmijët ishin ulur në pjesën më të largët të traktorit, rreth 4-5 metra larg Shaqir Gashit, nuk dëgjoi se çfarë u tha Kasum Gashi atyre. Shaqir Gashi i tha Kasum Gashit dhe Abedin Gashit që nëse e kanë problem që ai të kalojë përmes tokës së tyre, nuk do të kalojë më kurrë andej dhe se nuk ka nevojë që të vijnë të armatosur për ta takuar. Ai u kthye dhe nuk kaloi përmes tokës së tyre, por përmes tokës së dikujt tjetër. Pasi që zbritën fëmijët nga traktori, ai i pyeti se çfarë u kishte thënë Kasum Gashi dhe e bija i tha se ai u kishte thënë “do të vij në shtëpinë e juaj, t’ju q... nënën dhe t’ju vras secilin prej jush.”

Kur erdhi Hajriz Gashi për t’i ndihmuar që të shkarkojnë barin e thatë, Hajriz Gashi e pyeti se çfarë kishte ndodhur, prandaj i kishin fëmijët për incidentin e mëparshëm. Ai nuk deshi që i biri ta kuptonte se çfarë kishte ndodhur për shkak se u frikësohej telasheve dhe kishte frikë se Hajriz Gashi, duke qenë i ri, mund të bënte ndonjë gjë. Pasi që shkarkuan traktorin, Hajriz Gashi shkoi për të marrë gjënë dhe ky i tha Hajriz Gashit se nëse i takon Abedin Gashin dhe Kasum Gashi të largohej nga ata.

Më vonë shkoi për të ndihmuar Hajriz Gashi të kthente lopët. Pasi që i ndihmoi të birit, dhe derisa po kthehej në shtëpi, pa Rasim Gashi të kalonte rrugën pranë shtëpisë me traktor. U ndal në ballkonin e katit përdhese të shtëpisë që të zbathte këpucët. Ishte në anën e majtë të ballkonit kur pa Kasum Gashin dhe Abedin Gashin në rrugë rreth 4 apo 5 metra nga këndi i shtëpisë dhe rreth 10 deri në 12 metra nga ai dhe të drejtuar drejt tij. Abedin Gashi ishte më afër ndërsa Kasum Gashi ishte rreth gjysëm metri prapa tij. Abedin Gashi po qëndronte pa lëvizur dhe Shaqir Gashi i tha që të largonte kabllon dhe gypat e ujit nga fusha e Shaqir Gashit. Kasum Gashi nxorri një pistoletë të bardhë nga ana e majtë e rripit. E mbushi, përgatiti dhe e drejtoi nga Shaqir Gashi dhe shtëpia e tij. Kasum Gashi filloi të lëvizte në drejtim të Shaqir Gashit dhe shtëpisë së tij. Kasum Gashi i tha Abedin Gashit diçka të tillë sikur “a të gjuaj drejt tij dhe t’i q... nënën?”. Kur Shaqir



Gashi pa pistoletë, ai u frikësua dhe filloi të lëvizte drejt shtëpisë. Derisa po hynte në shtëpi, dëgjoji dy të shtëna: “bum bum!” dhe e pa të bijën, e cila ishte në korridor, të alivanosej. Ai nuk pa të birin gjatë gjithë incidentit.

Kur u fut në shtëpi, ai dëgjoji të shtëna të paktën njëshe apo mbase më shumë nga arma automatike. Të shtënat vinin nga shtëpia e tij. Pastaj ishte një përzierje të shtënash. Shpejt pa të bijën që ishte alivanosur. Pastaj shkoi lart shkallëve afër ballkonit dhe pa të birin Hajriz Gashi që po ecte vërdallë shumë i frikësuar dhe pothuajse i hunbur. Hajriz Gashi po mbante armë automatike AK 47. Ai kurrë më parë nuk e kishte parë këtë armë. I kërkoi të birin t’i jepte armën. Dëgjoji të shtëna vazhdimisht nga jashtë. Hajriz Gashi i dha armën, të cilën e mbajti në dorën e majtë derisa erdhi policia, por asnjëherë nuk e përdori. Doli në ballkon për të parë se çfarë kishte ndodhur. Nga ballkoni ai ia doli të shihte pjesën e poshtme të këmbëve të një personi që rrinte i shtrirë. Ai pa edhe Kasum Gashin tek qëndronte te porta e shtëpisë së tij dhe duke marrë një armë automatike Kalashnikov. Pa edhe Rasim Gashin me armë dhe me diçka tjetër në dorë. Kur Hajriz Gashi pa Kasum Gashin dhe Rasim Gashin të armatosur, u frikësua se mund të futeshin në shtëpi. I tha Shaqir Gashit “baba, më jep armën se do të na futen në shtëpi.” Ky i tha Hajriz Gashit se kurrë nuk do t’i lejonte që të futen. Kasum Gashi dhe Rasim Gashi filluan të vinin në drejtim të shtëpisë dhe rreth 35 apo 40 larg, Rasim Gashi po e kërcënonte duke i thënë: “do të gjuaj granata dorë dhe do të shfaros secilin prej jush.” Edhe Kasum Gashi bënte kërcënime të ngjashme. Nuk pa Kasum Gashin të ketë pësuar ndonjë lëndim. Ai ju tha “ejani dhe merreni!” duke iu referuar personit që kishte parë të shtrirë. Ai paralajmëroi Kasum Gashin dhe Rasim Gashin me zë të lartë dhe të qartë duke u thënë “nëse hyni në oborrin e shtëpisë sime, do të gjuaj” dhe këta u larguan. Njëri ndër të parët që iu afrua Abedin Gashit ishte Jahe Gashi. Ai nuk e pa Jonuz Gashin duke u afruar për të marrë trupin e Abedin Gashit.

Ai hyri brenda në shtëpi, zbriti shkallët dhe thirri komandantin e policisë. Pastaj u përpoq të qetësonte familjen. Policia erdhi pas 10 deri 15 minutasgh.

Dëshmitarja Lumturije Gashi, e bija e Shaqir Gashi tdeklaroi se më 20 shtator 2008 rreth orës 1 pasdite, kishte qenë në dhomën e ndejës në katin e parë. Motra e vogël Arlinda dhe vëllai i vogël Afrimi hynë brenda. Ata po qanin dhe i thanë asaj se derisa kishin qenë më të atin, kishin hasur Abedin Gashin, i cili kishte pasur armë dore dhe Kasum Gashin i cili kishte pasur armë me tytë të gjatë. Ata i thanë se Abedin Gashi dhe Kasum Gashi i kishin bërë titur të atit. Abedin Gashi nuk i kishte lejuar të kalonin nëpërmjet rrugës dhe i kishte kthyer të merrnin tjetër rrugë. Derisa kishin qenë të ulur prapa në traktor, Kasum Gashi u kishte thënë “do t’ju vras të gjithëve.”

Sapo i treguan të vegjlit këtë, ajo doli jashtë në ballkon për të pyetur të atin Shaqir Gashin se çfarë kishte ndodhur. Mirëpo, nuk kishin pasur kohë të bisedonin ngase ajo pa Abedin Gashin dhe Kasum Gashin në kënd të shtëpisë rreth 4 metra larg në anën e djathtë. Ajo pa edhe Rasim Gashin rrugës që po vinte nga shtëpia e tij në oborrin e tyre. Pastaj pa Kasum Gashin duke nxjerrë një armë dore të bardhë, duke e mbushur dhe duke ia drejtuar babait të saj me dorën e tij të djathtë. Nuk dëgjoji babanë të ketë thënë gjë. Kasum Gashi shante



“do t’ju q... nënën. Kaq ishte puna juaj.” Ajo u frikësua dhe u fut brenda. Kur arriti në korridor, dëgjoji të shtëna “bum bum”. Ajo u frikësua se të shtënat i kishin vrarë babanë dhe u alivanos. Nuk dëgjoji të shtëna të tjera.

Pasi që erdhi në vete, pa se babai po i binte shuplakë dhe pa edhe të vëllanë Hajriz Gashin. asnjëri prej tyre nuk kishte armë në dorë. Dëgjoji babanë duke thirrur policinë. Dëgjoji të atin duke thënë tre herë “ejani dhe merreni.”

Pasi që erdhi policia, ajo nga dritarja pa Kasum Gashin me armë të gjatë që mbante me dy duar dhe Rasim Gashin me një armë të zezë. Ata po vraponin drejt oborrit. Ajo pa edhe Jahe Gashin që po vinte në oborrin e tyre dhe Muje Gashin afër.

Ajo nuk dinte për ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet familjes së saj dhe asaj të Kasum Gashit lidhur me qasjen në tokë. As babai nuk i kishte thënë se çfarë kishte ndodhur ndërmjet atij dhe Abedin Gashit lidhur me kabllon e rrymës.

Dëshmitari Rasim Gashi, i biri i palës së dëmtuar Jonuz Gashi, deklaroi se më 20 shtator 2008 nga ora 8:10 deri më 12.30 kishte qenë në shtëpinë e xhaxhait Ramadan Gashi së bashku me të atin Jonuz Gashi. Vëllezërit e tij Abedin Gashi dhe Kasum Gashi ishin nisur për në fushat e arrave për të mbledhur arrat. Pas kthimit në shtëpi dhe pasi që ndërroi rrobat, rreth orës 12.40, shkoi në fushë për të ndihmuar vëllezërit. Ai kaloi nga rrugapranë shtëpisë së Shaqir Gashit për të shkuar deri te fushat e arrave. Kjo rrugë kalon nëpërmjet fushës së Muharemit, pra nuk kaloi përmes së Jonuz Gashit. Me të arritur, pa që vëllezërit kishin mbledhur të gjitha arrat. Abedin Gashi dhe Kasum Gashi nuk i thanë se u kishte ndodhur gjë derisa po shkonin në fushë. Ai nuk pa dhe nuk e diti nëse Abedin Gashi apo Kasum Gashi kishte armë me vete. Ata i vendosën thasët me arra në traktor dhe pastaj u nisën për në shtëpi duke marrë rrugën e njëjtë. Ai voziti i vetëm për shkak se nuk kishte vend për vëllezërit në traktor. Vëllezërit po vinin pas tij në këmbë rreth 100 larg. Pasi që u fut në lagje, nuk i pa vëllezërit më.

Ai u kthye te porta e shtëpisë së Jonuz Gashit në orën një dhe parkoi traktorin pak larg nga porta, e ndali motorin dhe filloi të shkarkonte thasët me arra. Tani dëgjoji dikë duke thënë “me sot e pate.” Por nuk pa as Shaqir Gashin as Hajriz Gashin dhe as ballkonin e shtëpisë së Shaqir Gashit. Zëri po vinte nga 30-35 metra larg. Fjalët u thanë aq zëshën sa të dëgjonte e gjithë lagja. Rasim Gashi njohu zërin e Shaqir Gashit. Nuk dëgjoji askë tjetër duke folur.

Pas fjalëve “me sot e patë.” Shaqir Gashi urdhëroi të birin Hajriz Gashi të shtinte duke i thënë “gjuaj! Çfarë po pret?” dhe i përsëriste fjalët e njëjta. Tani Rasim Gashi dëgjoji të shtënat e para. Këto vinin nga shtëpia e Shaqir Gashit dhe ishin me ndërprerje. Pastaj Shaqir Gashi urdhëroi të birin të hedhte bomba për të vrarë Abedin Gashin dhe Kasum Gashin.

Me të dëgjuar të shtënat, prindërit erdhën te porta e shtëpisë së Jonuz Gashit. Pas të dëgjimit të të shtënave, rreth 10 minuta më vonë pa të vëllanë Kasum Gashi të vinte në



shtëpinë e Jonuz Gashit. Kasum Gashi i tha se Hajriz Gashi po shtinte nga ballkoni dhe se Abedin Gashi është vlarë dhe kishte mbetur në vend. Së bashku me prindërit, lëvizti rreth 7-8 metra nga porta për të shkuar te Abedin Gashi dhe këtu Rasim Gashi mund të shihte Shaqir Gashin duke qëndruar i vetëm në ballkonin e katit të parë të shtëpisë. Shaqir Gashi po mbante një armë automatike dhe ishte në pozicion për të shtënë dhe po bërtiste “do të ju q... nënën. Do të ju shfarosi të gjithëve.” Pastaj Shaqir Gashi shtiu me ndërprerje me Kalashnikov, prandaj nuk ia dolën t’i afrohen Abedin Gashit.

Rasim Gashi nuk dëgjoi të shtënanga armë tjetër përpos nga ajo automatike. Rasim Gashi nuk shkoi të merrte vetë një armë se ishte më e rëndësishme të merrte të vëllanë Abedin Gashi dhe t’i ndohmonte se sa të merrte një armë. Ai dhe prindërit nuk ia dolën të merrnin trupin e Abedin Gashit nga rruga para se të vinte policia. Abedin Gashi mbeti i shtrirë në tokë rreth 10-15 minuta derisa erdhi policia dhe vdiq.

Dy zyrtarë të policisë, të cilat janë dëshmitarë erdhën dhe takuan edhe Kasum Gashin, i cili ishte i lënduar. Pyetën Kasum Gashin se çfarë kishte ndodhur. Ai u tha se Shaqir Gashi e kishte qëlluar nga ballkoni. Polici voziti me veturën e vëllait të Rasim Gashit deri në spital në Skenderaj. U deshën rreth 25 minuta për të ardhur për shkak se rrugët janë të paasfaltuara.

Dëshmitari Muje Gashi deklaroi se është në lidhje familjare të largët me Shaqir Gashin.

Më 20 shtator 2008 rreth orës 1 ishte duke shkuar në punë. Ai udhëtonte për në punë me veturë së bashku me Jahe Gashin. Jahe Gashi po e priste në veturë në udhëkryqin ndërmjet shtëpisë së tij dhe asaj të Jonuz Gashit.

Derisa ishte rrugës për të takuar Jahe Gashi, i biri po insistonte t’i blinte një gjë nga shitoretja para se të shkonte në punë. U përpoq të shkonte në shitore me të birin, por ajo ishte e mbyllur. Derisa po trokiste në derën e shitores, dëgjoi të shtëna. Nuk dëgjoi britma. Ai pa të bijën e pronarit dhe pyeti nëse mund ta hapte shitoren. Pyeti se a është fejuar dikush.

Ai mund të shihte shtëpinë e Jonuz Gashit vetëm nëse zbriste pak teposhtë, gjë që edhe e bëri. Ai pa rrugën, gjithë shtëpinë dhe shumë njerëz. Ai njohu Jonuz Gashin, Kasum Gashin dhe anëtarët e tyre të familjes, emrat e të cilëve nuk i dinte. Deris apo qëndronte pranë shitores, shumë fëmijë i kishin thënë Jahe Gashit se diçka u kishte ndodhur Kasum Gashit dhe Shaqir Gashit. Pastaj erdhi Jahe dhe shkuan për të parë se çfarë kishte ndodhur. Ai pa vetëm Kasum Gashin kur arritën te porta e shtëpisë së Jonuz Gashit. Edhe Jonuz Gashi ishte aty. Kasum Gashi kishte gjithë dorën e gjakosur dhe po i binte poshtë. E pyeti Kasum Gashin se çfarë kishte ndodhur. Kyi fundit i tha “Shaqiri na vrau.”

Ai u tha ta ndihmonin Kasum Gashi, por Jonuz Gashi as e shoqja e tij u larguan për të parë se si ishte Abedin Gashi. Ata i thanë ta merrte Abedin Gashin, nëse është e mundur, i cili ishte në rrugë. Ai dhe Jahe ishin të parët që shkuan te Abedin Gashi dhe erdhën shumë të afërm që jetojnë në lagjen e njëjtë. Kaluan rreth 3 - 4 minuta prej kohës që



dëgjoji të shtënat e derisa shkoi te Abedin Gashi. Derisa po i afrohej Abedin Gashit nuk dëgjoji ndonjë kërcënim nga ana e Shaqir Gashit apo Hajriz Gashit apo dikujt tjetër dhe askush nuk u përpoq ta ndalte. Në të vërtetë, fare nuk e ka parë Shaqir Gashin apo Hajriz Gashin atë ditë.

Pa Abedinin të shtrirë në tokë. Nuk pa ndonjë armë pranë tij. Nuk pa askë tjetër me armë. Pa ca njolla gjaku në trupin e Abedin Gashit dhe vrapoi për ta ndihmuar atë. Së bashku me Jahe kërkoi nga të bijtë e Ramadanit të sjellnin një veturë. Pas një apo dy minuti, erdhi vetura dhe vendosën Abedinin në ulësen e pasme si dhe Kasum Gashin. ai po i dërgonte në ambulancën në Skenderaj. Nuk kaloi shumë kohë për të arritur aty.

Dëshmitari Jahe Gashi deklaroi se është në lidhje familjare të largët me Shaqir Gashin.

Më 20 shtator 2008 rreth orës një ishte në fshat dhe po nisej në punë. Ai kishte për të takuar Muje Gashin ën fshat pranë një fushe ku takoheshin çdo ditë. Ishte kjo rreth 100 metra larg shtëpisë së Jonuz Gashit.

Priti rreth dhjetë minuta Muje Gashin për të arritur te vetura e tij. Ai nuk dëgjoji gjë sepse kishte të ndezur radion dhe nuk e kishte vëmendjen aty. Para Muje Gashit erdhën një grup fëmijësh dhe i thanë se kishte ndodhur një incident në mes të bijve të Shaqir Gashit dhe atyre të Jonuz Gashit. Nga vetura e tij nuk ia doli të shihte lokacionin e trupit të Abedin Gashit. Doli nga vetura dhe hasi në Muje Gashin. së bashku shkuan drejt këtyre familjarëve.

Me t'u afruar shtëpisë së Jonuz Gashit, takoi Kasum Gashin, i cili kishte dorën e lënduar. Nuk kishin shumë kohë për të biseduar, por ëe pyeti atë se me kënd kishte pasur telashe apo kujt i kishte shkaktuar telashe. Kasum Gashi tha se kishin ca telashe me Shaqir Gashin dhe se mendoi se Abedini ishte vrarë dhe kishte ngelur në rrugë afër shtëpisë së Shaqir Gashit. Kasum Gashi kërkoi nëse mund ta merrte Abedin Gashin nga aty. Ky i premtoi se do ta bënte këtë.

Abedin Gashi ishte i shtrirë në tokë rreth 10 mëetra larg shtëpisë së Shaqir Gashit. Nuk pa ndonjë armë përreth. Ai ishte i pari që iu afrua Abedin Gashit, dhe më vonë erdhi Muje Gashi me anëtarët e familjes, të afërm dhe të largët. Askush nuk u përpoq ta ndalte derisa po i afrohej Abedin Gashit. Përkundrazi prej deklaratës, Avokati Mbrojtës i sqaroi Trupit Gjykues se shprehja shqipe 'me nxjerre' e përdorur nga do të thotë të nxjerret dikush, duke nënkuptuar kështu se kishte pasur pengesë për diçka të tillë. Nuk biseduan me Abedin Gashin sepse vetëm u përpoqën ta ndihmojnë sa më shpejt që është e mundur. Nuk e din nëse Abedin Gashi ishte akoma gjallë.

Ai kërkoi nga i biri i Ramadanit një veturë që të voziste. Fillimisht vendosën Abedin Gashin në pjesën e prapme të veturës dhe pastaj Kasum Gashin në ulëset e përparme. U deshëm jo më shumë se 15-20 minuta për të sjellur Abedinin dhe Kasumin në qendrën e shëndetit në Skenderaj.



Nuk pa e as nuk dëgjoi gjë nga Shaqir Gashi apo nga Hajriz Gashi atë ditë.

Dëshmitarja Mirsade Gashi ushtroi të drejtën për të mos dhënë deklaratë.

Dëshmitari ekspert, mjeku ligjor Arsim Gerxhaliu deklaroi se më 20 shtator 2008, i ndjeri Abedin Gashi është qëlluar me një plumb të vetëm, i cili lëndoi pjesën e mesme të mushkërive dhe trakenë. Sipas mendimit të tij, shkaku i vdekjes është raportuar në mënyrë të saktë në raportin e autopsisë të datës 21.9.2008.

Nuk ka qenë e mundur të shpëtohet jeta e Abedin Gashit edhe po të kishte pasur ndihmë mjekësore brenda një minuti.

D. Vlerësimi i provave të prezantuara

1. Gjetjet faktike

Në mesin e provave të prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor, Trupi Gjykses vlerëson se provat në vijim janë vërtetuar:

Në mëngjesin e 20 shtatorit 2008 kur Shaqir Gashi ishte nisur rrugës për në fushë, ky takoi Kasum Gashin dhe Abedin Gashin. këta ndaluan Shaqir Gashin që të kalonte përmes tokës së tyre.

Më vonë gjatë ditës së njëjtë, Kasum Gashi dhe Abedin Gashi kaluan përgjatë rrugës pranë shtëpisë së Shaqir Gashit. Derisa po e bënë këtë, ata takuan Shaqir Gashin. Abedin Gashi dhe Shaqir Gashi diskutuan çështjen e largimit të kabllit elektrik.

Faktet në vijim mbështetn nga deklaratat e dhëna nga Shaqir Gashi dhe Jonuz Gashi.

I akuzuari **Hajriz Gashi** ishte në posedim të armës automatike AK 47 të kalibrit 7,62x39mm me numrin serik C-43367 dhe se kishte përdorur këtë armë për të shtënë në drejtim të Abedin Gashit dhe Kasum Gashit nga ballkoni i katit të parë të shtëpisë së Shaqir Gashit duke vrarë kështu Abedin Gashin dhe duke shkaktuar lëndime serioze Kasum Gashit.

Ky fakt është mbështetur nga deklaratat e Hajriz Gashit, i cili konfirmoi se ka gjetur dhe pastaj e ka fshehur armën në shtëpi. Ai poashtu e pranoi se këtë armë e përdori për të shtënë në drejtim të Abedin Gashit dhe Kasum Gashit në mënyrë që të mbronte familjen e tij nga një sulm i kuptuar që do të ushtrohej nga Abedin Gashi dhe Kasum Gashi. Policia gjeti armën në vendngjarje. Shaqir Gashi mohoi të ketë ditur gjë për armën apo ta ketë përdorur.



I akuzuari **Kasum Gashi** kishte pistoletën Crvena Zastava M-57 të kalibrit 7,62x25 mm me numrin serik C-139535 me vete dhe në një kohë të caktuar, kishte shtënë me të në drejtim të dhomës lart në shtëpinë e Shaqir Gashit.

Ky fakt mbështetet nga deklarimi i Kasum Gashit si fajtor ndaj pikës së akuzës Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve. Deklarimi i tij i fajësisë gjithashtu është mbështetur edhe nga deklaratat e dhëna nga Hajriz Gashi dhe Shaqir Gashi, të cilët thanë se kanë parë Kasum Gashin me armë. Kjo mbështetet edhe nga Raporti Hetues, sipas së cilit pistoletë Crvena Zastava, me numrin serik C-139535 e konfiskuar nga shtëpia e Jonuz Gashit, skica e vendngjarjes, e cila tregon se ku janë gjetur gëzhojat, si dhe raporti i balistikës, sipas së cilit, 5 nga gëzhojat përputhen me pistoletën e marrë në shtëpinë e Gashit. Kjo mbështetet edhe nga një fakt tjetër, sipas së cilit, dritarja e shtëpisë së Shaqir Gashit në katin e parë kishte tre vrima të shkaktuara nga plumbi, siç edhe lexon raporti për ekzaminimin e vendngjarjes.

Si pasojë e përdorimit të armës nga ana e Hajriz Gashit, Abedin Gashi pësoi të shtëna arme në gjoks, me ç'rast u dëmtuan mushkëritë dhe vertebra torakale. Lëndimi në fjalë shkaktoi gjakderdhje të madhe, shok hipovolemik dhe vdekje. Jeta e tij nuk ka mundur të shpëtohet edhe në rast të intervenimit të menjëhershëm mjekësor.

Ky fakt mbështetet nga raporti i autopsisë dhe nga dëshmia e dhënë nga dëshmitari ekspert Dr. Arsim Gerxhaliu.

Si pasojë e përdorimit të armës nga ana e Hajriz Gashit, Kasum Gashi pësoi të shtëna arme që shkaktoi frakturë të shkallës më të lartë në dorën e tij të djathtë. Dora e është shkurtuar 3cm pas një intervenimi të nevojshëm kirurgjik (osteosintaza) më 28 tetor 2008. Në të njëjtën kohë është rindërtuar nervi radial nëpërmjet transplantit suralis. Mirëpo, mbetet të kuptohet nëse nervi do të shërohet.

Ky fakt mbështetet nga dokumentacioni mjekësor i nxjerrë nga QKUK në Prishtinë dhe Klinika në Eëels-Grieskirchen.

2. Prova lidhur me vrasjen dhe vrasjen në tentativë nga Hajriz Gashi

Siç u tha më lart, Hajriz Gashi pranoi se ka shtënë në drejtim të Abedin Gashit dhe Kasumit, në këtë mënyrë duke vrarë Abedin Gashin dhe duke shkaktuar lëndime serioze Kasum Gashit. Mirëpo, Hajriz Gashi pretendon se këto veprime i ka kryer për të mbrojtur familjen e tij dhe veten nga sulmi i Kasum Gashit, i cili po i qëllonte me armë dhe i cili kishte kërcënuar të atij e tij se do të vinte në shtëpinë tyre dhe do t'i vriste që të gjithë.

Çështja kryesore e këtij shqyrtimi, duke pasur parasysh vrasjen dhe vrasjen në tentativë të kryer nga Hajriz Gashi, është nëse i akuzuari Hajriz Gashi me të vërtetë ka vepruar në mbrojtje të nevojshme apo nëse ka pasur për qëllim të shuajë jetën e Abedin Gashit dhe atë të Kasum Gashit siç pretendon aktakuza.



2.1 Versioni i Hajriz Gashit

Deri në një pikë të caktuar, deklarata e dhënë nga Hajriz Gashi përputhet me atë të Shaqir Gashit. Që të dy përshkruan se si Abedin Gashi dhe Kasum Gashi në një rënë anë dhe Shaqiri në anën tjetër diskutuan dhe se si Kasum Gashi nxorri armën dhe shtiu dy herë. Që të dy thanë se Hajriz Gashi i dha armën Shaqir Gashit në shkallët afër ballkonit të katit të parë pas të shtënave dhe se pas kësaj, asnjëri prej tyre nuk e përdorën armën. Shaqir Gashi thirri policinë nga dhoma e ndejës në katin përdhësë.

Dëshmitarja Lumturije Gashi deklaroi se ishte në ballkon së bashku me Shaqir Gashin kur Kasum Gashi nxorri armën dhe ia drejtoi Shaqir Gashit. Shaqir Gashi nuk e përmend se ka qenë ajo në ballkon me të. Në vend të kësaj, Shaqir Gashi shprehimisht thotë se pa të bijen vetëm kur u fut brenda në shtëpi. Prandaj, trupi Gjykues është i mendimit se deklarata e Lumturije Gashit lidhur me ndodhitë para alivanosjes së saj është e palogjikshme dhe e ndikuar nga lidhjet familjare.

Dëshmitari Muje Gashi deklaroi se kur pa Kasum Gashin, ky i fundit i kishte thënë "Shaqiri na vrau." Kjo deklaratë përsëritet nga Rasim Gashi dhe Jahe Gashi.

Trupi Gjykues është i mendimit se dy pjesë të deklaratës së Hajriz Gashit kanë mangësi logjike. Pjesa e parë është sqarimi i Hajriz Gashit i arsyes pse ai pasi që nxorri armën automatike, e vendosi atë në dysheme në korridor për të dalur sërish në dritare edhe pse e dinte se më herët gjatë ditës, Kasum Gashi kishte kërcënuar jetën e babait dhe atë të të gjithë familjes, dhe edhe pse e ka parë Kasum Gashin duke shtënë prej një largësie të afët në drejtim të vendit ku ka bnesuar se gjendet i ati. Pjesa e dytë është pretendimi se edhe pse nuk paralajmëroi me fjalë apo nuk shtiu fillimisht në ajr, qëllimi i tij i të shtënave nga ana e tij ishte vetëm të frikësonte Abedin Gashin dhe Kasum Gashin në mënyrë që këta të shkonin.

Deklarata e Hajriz Gashit nuk mbështetet nga raporti i ekzaminimit të vendngjarjes, sipas së cilit, dritarja në katin e parë të shtëpisë së Shaqir Gashit kishte tre vrima. Gjykata nuk mund të kuptojë asnjë sqarim logjik se pse Kasum Gashi do të shtinte në këtë drejtim po të kishte parë vetëm Hajriz Gashin në ballkonin e katit të parë. Kjo konfirmohet nga skica e vendngjarjes, sipas së cilës janë gjetur dy plumba afër njëri tjetrit në rrugës drejt ballkonit të katit të parë dhe një grup tjetër prej tre plumbash poshtë rrugës afër dritares. Kjo sugjeron se Kasum Gashi ka shtënë, ka lëvizur dhe sërish ka shtënë.

Pastaj ka papërputhshmëri në deklaratën e Hajriz Gashit lidhur me kohën e incidentit. Hajriz Gashi deklaroi i gjithë incidenti zgjati rreth 30, 40 apo 50 sekonda, as një minutë të plotë dhe pastaj u fut në shtëpi dhe pa babanë Shaqir Gashi te shkallët. Trupi Gjykues është i mendimit se do të duhej më shumë se një minutë që Kasum Gashi të shtinte me armë, Hajrizi të futej brenda, të shkonte në korridor për të marrë armën, të futej sërish brenda, të shkonte në korridor për të marrë armën, të kthehej në ballkon dhe të shtinte në drejtim të Abedin Gashit dhe Kasum Gashit. Pastaj u kthye sërish në shtëpi dhe pa babanë. Koha në deklaratë është në kundërshtim me atë të Shaqir Gashit, i cili tha se kur u fut në shtëpi, dëgjoi të shtëna nga arma automatike nga shtëpia e tij. Shpejt pa të bijen e



cila ishte alivanosur dhe u ngjit shkallëve afër derës së ballkonit, ku pa të birin që sillej vërdallë. E gjithë kjo sigurisht se ka zgjatur më shumë se një minutë.

Hajriz Gashi gjithashtu deklaroi se derisa ishte në dhomën e ndejës në katin përdhësë, pasi që ka shtënë drejt Abedin Gashit dhe Kasum Gashit, nuk pa Kasum Gashin të ketë pësuar lëndime, por që po mbante një armë automatike me të dy duart. Mirëpo ai nuk mohon që Kasum Gashi është lënduar nga të shtënat e tij. Trupi Gjykues është i mendimit se lëndimi që pësoi Kasum Gashi ishte aq serioz saqë nuk ka mundur të mbajë armë me dorën e lënduar.

Sikurse papërputhshmëri, ka edhe kundërshtime të pazgjedhura në mes të deklaratës së Hajriz Gashit dhe asaj të Shaqir Gashi. Hajriz Gashi tha se Kasum Gashi i tha “ku po shkon o q... nënë” atij pasi që e pa duke shikuar nga dritarja e katit të parë, por këtë gjë nuk e përmend fare Shaqir Gashi. Për më tepër, Hajriz Gashi tha se dëgjoi një zë femre duke britur “e vranë” por as këtë nuk e përmend Shaqir Gashi në deklaratën e tij edhe pse tani ishte brenda në shtëpi, në katin përdhësë afër dhomës së ndejës. Së fundi, Hajriz Gashi dëgjoi Rasim Gashin duke britur me zë të lart “futemi brenda dhe t’u hedhim bombën” por prap, Shaqir Gashi nuk e përmend këtë fare në deklaratën e tij. Trupi Gjykues nuk është i mendimit se lëshime të tilla në deklaratën e Shaqir Gashit janë pasojë e mungesës së memories.

Për më tepër, Hajriz Gashi deklaroi se dëgjoi dy të shtëna, pastaj katër apo pesë. Ai tha se derisa po shtine, nuk dëgjoi armë të tjera të jenë përdorur e as nuk përmend të ketë dëgjuar të shtëna të tjera. Shaqir Gashi deklaroi se pas dëgjimit të të shtënave nga arma automatike, dëgjoi një përzjerje të shtënash.

Përfundimisht, në deklaratën e tij Hajriz Gashi nuk e përmend të ketë kërkuar që babai t’i kthejë armën. Shaqir Gashi tha se pasi që pa Rasim Gashin të armatosur, Hajriz Gashi u frikësua dhe tha “baba, më jep armën se do të na futen në shtëpi.”

2.2 Versioni i Jonuz Gashit

Jonuz Gashi deklaroi se pak para orës një kishte qenë në oborrin e tij dhe kishte dëgjuar 4 apo 5 të shtëna nga arma automatike. Ai nuk deklaroi se ka dëgjuar ndonjë diskutim apo britma para të shtënave. Tani, ai nuk mund të shihte se cili po shtinte. Në pyetjen se a kishte ndonjë ndryshim në mes të shtënave që dëgjoi Jonuz Gashi deris a ishte akoma në oborr dhe atyre që pa Shaqir Gashin duke shtënë më vonë, ai deklaroi se nuk ka mundur të vërejë ndryshimin. Më vonë, gjatë deklaratës së tij, ai tha se në përgjithësi mund të dallonte ndryshimin në mes të shtënave nga arma automatike dhe pushka.

Jonuz Gashi deklaroi se Kasum Gashi i kishte thënë atij që Shaqir Gashi i kishte thënë Hajriz Gashit “gjuaj! Çfarë po pret?” dhe se Hajriz Gashi pastaj shtiu drejt Kasum Gashit dhe Abedin Gashit. Trupi Gjykues është i mendimit se fare nuk është e logjikshme që Jonuz Gashi, i cili gjendej në kopsht, të mos dëgjonte urdhrin nëse ishte nga jashtë shtëpisë pranë asaj të Jonuz Gashit.



Që të dy Hajriz Gashi dhe Shaqir Gashi mohojnë të jetë dhënë një urdhër i tillë.

Ka kundërshtime të pazgjidhura në mes të deklaratës së Jonuz Gashit dhe asaj të Rasim Gashit. Rasim Gashi nuk përmend të ketë dëgjuar diskutime në mes të Shaqir Gashit dhe Abedin Gashit apo Kasum Gashit para të shtënave edhe pse ka qenë afër vendit ku është bërë diskutimi.

Jonuz Gashi dhe Rasim Gashi deklaruan në dëshmitë e tyre se nuk dëgjuan të shtëna nga armë të tjera përpos nga ajo automatike, gjë që është në kundërshtim me katin e vërtetuar se është shtënë nga dy armë të ndryshme, nga pistoleta dhe arma automatike.

Dëshmitari Muje Gashi deklaroi se dëgjoji të shtëna, por nuk mund të thoshte asgjë më shumë rreth tyre. Dëshmitari Jahe Gashi fare nuk dëgjoji të shtëna.

Prandaj, për shkak të ekzistimit të papërputhshmërive në deklaratat e personave që u dëgjuan në sallë të gjyqimit dhe për shkak të ndryshimeve në mes të deklaratave, Trupi Gjyqësor është i mendimit se është e pamundur të përcaktohet nëse ndonjë prej personave të dëgjuar ka thënë të vërtetën absolute.

3. Prova lidhur me nxitje për vrasje dhe nxitje për vrasje në tentative nga Shaqir Gashi

Në deklaratat e tyre, Shaqir Gashi dhe Hajriz Gashi nuk përmendin të kenë bisedaur me njëri-tjetrin para se të takoheshin në korridorin e katit të parë dhe Shaqir Gashi të ketë kërkuar nga Hajriz Gashi t'i dorëzojë armën.

Po të kishte qenë qëllimi i Shaqir Gashit që të vriste që të dy Abedin Gashin dhe Kasum Gashin, duket e pakujdesshme nga ai që të vendosë veten e tij në rrezik të vritej nga armët që i kishte parë duke i bartur më herët gjatë ditës duke qëndruar në ballkon në vend se të priste brenda që ata të kalpjnë dhe të përdorte armën vetë. Trupi Gjyqësor është i mendimit se prita e pretenduar dhe qëllimi për të vrarë Abedin Gashin dhe Kasum Gashi nga Shaqir Gashi, ka mungesë logjike.

Rasim Gashi deklaroi se dëgjoji të shtënat e para pasi që Shaqir Gashi tha “me sot e patë” me aq zë të lart sa që e gjithë lagja ka mund ta dëgjojë këtë dhe urdhëroi të birin Hajriz Gashin vazhdimisht që të shtinte duke i thënë “Gjuaj! Çfarë po pret?” pretendohet se Shaqir Gashi urdhëroi Hajriz Gashin që të hedhte bomba për të vrarë që të dy Abedin Gashin dhe Jonuz Gashin. Jonuz Gashi, i cili ishte në oborrin e shtëpisë pranë në deklaratën e tij nuk përmend të ketë dëgjuar Shaqir Gashin duke thënë ndonjë prej këtyre fjalëve. Në pyetjen se a ka dëgjuar ndonjë gjë tjetër Dëshmitari Muje Gashi deklaroi se përpos të shtënave nga arma, pa ndonjë hezitim tha se nuk ka dëgjuar gjë, përfshirë këtu edhe britmat.

Prandaj, Trupi Gjyqësor nuk përcakton përtej çdo dyshimi të bazuar se Shaqir Gashi ka nxitur të birin në cilëndo mënyrë për të vrarë Abedin Gashin dhe të tentojë të vret Kasum Gashin.



Provat lidhur me pronësinë, kontrollin, posedimin dhe përdorimin e paaautorizuar të armëve nga Shaqir Gashi

Shaqir Gashi mohoi të ketë parë ndonjëherë armën para se i biri Hajriz Gashi t'ia ketë dorëzuar atë në korridor. Ai mohon të ketë shtënë me të ndonjëherë.

Hajriz Gashi deklaroi se armën e ka gjeturrreth 2 apo 3 vjet më parë dhe se e ka fshehur në shtëpi pa i treguar babait. Në pyetjen se si është e mundur që i biri të mbante një gjë të tillë të fshehtë nga babai, Hajriz Gashi sqaroi se kishte frikë se babai do t'ia merrte.

Trupi Gjykues vlerëson se deklarata e Jonuz Gashit në mënyrë indirektebie në kundërshtim me Raportin Identifikues Forenzik, i cili lexon se janë gjetur 8 gëzhoja në ballkonin e katit të parë. Përpos kësaj, është gjetur një gëzhojë në korridor, pranë ballkonit. Për më tepër, Raporti i Balistikës lexon se arma e konfiskuar nga shtëpia e Shaqir Gashit kishte karikator me kapacitet për 37 plumba dhe 22 plumba. Prandaj, Trupi Gjykues vlerëson se nuk ka gjasa që që të dy, Hajriz Gashi dhe Shaqir Gashi të kenë shtënë me armën.

Në deklaratat e tyre, Muje Gashi dhe Jahe Gashi mohojnë të jetë përpjekur kush që t'i ndalojë t'i afrohen trupit të Abedin Gashit.

Prandaj, nuk ka prova që përcaktojnë përtej dyshimit të bazuar se Shaqir Gashi përdori armën vetë apo që ishte në dijeni për të.

5. Kërkesat e hedhura poshtë

Avokati Mbrojtës Arif Hasi bëri kërkesë që i pandehuri Kasum Gashi të dëgjohet edhe në cilësinë e dëshmitarit për shkak se është palë e dëmtuar.

Kryetari i Trupit Gjykues hodhi poshtë këtë kërkesë ngase ligji nuk lejon të merret në pyetje i pandehuri në cilësinë e dëshmitarit. Dëshmitarët janë të obliguar që të përgjigjen në pyetje dhe të thonë gjithë të vërtetën, ndërsa obligimi i njëjtë nuk vlen për të akuzuarin. Do të ishte shkelje e madhe e të drejtave të të akuzuarit po qe se ai do të merrej në pyetje si dëshmitar dhe të detyrohej që të përgjigjej në pyetje dhe të thotë të vërtetën.

E. KUALIFIKIMI LIGJOR

Name: Verdict
Job Number: A - 829

Translated by: SC

Page: 21 of 25



1. Ligji i zbatuar

Veprat penale janë kryer më 14 qershor 2008. në atë kohë, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i cili hyri në fuqi më 6 prill 2004, ishte ligji në fuqi. Në pajtim me Nenin 2, paragrafi (1), KPPK, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të zbatohet për kryerësin. Nuk ka ndryshim në ligj për të qenë më në favor për të akuzuarit. Edhe pse aktakuza kundër tyre është ngritur sipas Kodit Penal të Kosoës, i cili u fut në fuqi më 6 janar 2009, Trupi Gjykses i është referuar dispozitave të KPPK si ligji i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale. Mirëpo, me rastin e lirimt nga aktakuza, është dashur të lirohen nga aktakuza origjinale.

2. Mbrojtja e nevojshme

Siç u tha më lart, është e qartë dhe e padiskutueshme që i akuzuari Hajriz Gashi shkaktoi vdekjen e Abedin Gashit dhe lëndimet serioze të Kasum Gashit.

Në pajtim me Nenin 8, paragrafi 1, KPPK, vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk përbën vepër penale. Prandaj, në rast të tillë, i akuzuari lirohet.

Në pajtim me Nenin 8, paragrafi 2, KPPK, mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atqasshëm ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.

Në këtë rasy, Trupi Gjykses nuk ka mundur të përcaktojë se Hajriz Gashi ka vepruar në mbrojtje të nevojshme dhe as nuk ka mundur të përjashtojë këtë mundësi për shkak të kundërshtimeve dhe papërputhshmërive të shumta në deklaratat e që të dy palëve siç u përmend nën D/2. Prandaj, Hajriz Gashi u lirua nga pika e akuzës për vrasje në pajtim me Nenin 146, KPP dhe ajo e vrasjes në tentativë në pajtim me Nenin 146 dhe 20, KPPK dhe në pajtim me Nenin 390, Pika 3, KPPK dhe jo sipas Nenit 390, Pika 1, KPPK lidhur me Nenin 8, Paragrafi (1), KPPK.

Shaqir Gashi është ngarkuar me nxitje për të kryer vrasje në pajtim me Nenin 146 dhe 24, KPPK dhe nxitje për të kryer vrasje në tentativë në pajtim me Nenin 146, 20 dhe 24, KPPK. Siç u përmend nën D/3, provat e prezantuara gjatë shqyrtimit kryesor nuk mjaftuan për të dëshmuar përtej çdo dyshimi të bazuar se ka nxitur të birin për të vrarë Abedin Gashin dhe për të tentuar të vrasë Kasum Gashin. Prandaj, është liruar në pajtim me Nenin 390, Pika 3, KPPK.

Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paautorizuar i armëve

Prokurori Publik ngriti aktakuzë duke ngarkuar të akuzuarit Hajriz Gashi dhe Kasum Gashi me pronësi, kontroll, posedimin dhe përdorim të paautorizuar të armëve, mirëpo, për shkak se Trupi Gjykses nuk ka mundur të përjashtojë mundësinë që të dy palët kanë përdorur armën në mbrojtje të nevojshme, Trupi Gjykses ka përcaktuar fajësinë e që



të dy të akuzuarve në formën e privilegjuar të të njëjtës veprë penale në pajtim me Nenin 328, paragrafi (2), KPPK.

Edhe Shaqir Gashi është ngarkuar me pronësi, kontroll, posedimim dhe përdorimim të paaautorizuar të armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 1, KPK.

Mirëpo, siç u cekë nën D/4, nuk ka prova që vërtetojnë se ky ishte në dijeni mbi armën automatike AK 47, të përdorur nga i biri në ditën kritike apo se ai vetë e përdori atë.

Prandaj, ai është liruar nga kjo pikë e akuzës në pajtim me Nenin 390, Pika 3, KPPK.

F. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

Gjatë sjelljes së sanksionimit kriminal, Trupi Gjykses duhet të ketë parasysh qëllimin e përgjithshëm të dënimit – pra ndalimin e aktiviteteve të dëmshme për shoqërinë duke i larguar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale dhe qëllimin specifik – parandalimi i kryerësit nga përsëritja e veprës. Gjatë përcaktimit të kohëzgjatjes së dënimit, Trupi Gjykses duhet të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese në pajtim me Nenin 64, paragrafi (1), KPPK.

Gjatë përcaktimit të dënimit, në rastin e dy të akuzuarve, Trupi Gjykses vlerësoi si faktor rëndues pasojat e rënda të përdorimit të armës në këtë rast specifik.

Trupi Gjykses vlerësoi si faktor lehtësues faktin se asnjëri prej të akuzuarve nuk kishte dosje penale.

Për veprën penale Pronësi, kontroll, posedimim dhe përdorimim të paaautorizuar të armëve në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 2, KPPK, ligji parasheh dënimin deri në 8 vjet burgim.

Duke marrë parasysh faktorët lehtësues dhe rëndues, Trupi Gjykses sjellë vendim për 4 vjet burgim për veprën penale të Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paaautorizuar i armëve, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 2, KPK, sa i përket Hajriz Gashit.

Trupi Gjykses sjellë vendim për 3 vjet burgim për veprën penale Pronësia, kontrolli, posedimi dhe përdorimi i paaautorizuar i armëve sa i përket Kasum Gashit duke marrë parasysh se ai vetë është lënduar gjatë kësaj ngjarje tragjike.

I akuzuari Hajriz Gashi ka qenë në paraburgim që nga 20.9.2008 deri më 11 janar 2010. Kjo periudhë do të llogaritet në dënimin e sjellur në pajtim me Nenin 73 paragrafi (1), KPPK.



Trupi Gjykses konfiskoi dy armët që janë përdorur ditën kritike si dhe armën AK 47, e cila është gjetur në shtëpinë e Jonuz Gashit. Arma e katërt, e cila është gjetur dhe konfiskuar në shtëpinë e njëjtë do të do të kthehet me një vendim të veçantë sapo Jonuz Gashi apo përfaqësuesi i tij ligjor të sjellë lejen e vlefshme për këtë armë.

G. SHPENZIMET

Të akuzuarit Hajriz Gashi dhe Kasum Gashi janë shpallur fajtor, prandaj ata do të kompensojnë shpenzimet për procedurën penale në pajtim me Nenin 102, paragrafi (1), KPPK përpos shpenzimeve për përkthim gjatë procedurës. Një vendim i veçantë lidhur me shumën e këtyre shpenzimeve do të nxjerret nga Gjykata sapo të merren të dhënat e nevojshme në pajtim me Nenin 100, paragrafi (2), KPPK.

Pasi i akuzuari Shaqir Gashi është liruar nga të gjitha pikat e akuzës, ai nuk duhet të kompensojë shpenzimet e procedurës penale. Kjo e fundit do të paguhet nga burimet buxhetore në pajtim me Nenin 103, paragrafi (1), KPPK.

H. KËRKESA PËR KOMPENSIM

Në fillim të shqyrtimit kryesor, pala e dëmtuar është përkujtuar se mund të ushtrojë një kërkesë për kompensim gjatë procedurës penale në pajtim me Nenin 355, paragrafi (2), KPPK.

Pala e dëmtuar Jonuz Gashi nuk ka ushtruar kërkesë të tillë.

**Gjykata e Qarkut në Mitrovicë
P. nr. 24/09**



Përpiluar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetari i Trupit Gjykses
Hajnalka Veronika Karpati

Anëtar i Trupit Gjykses
Charles Smith

Anëtar i Trupit Gjykses
Klaus Jung



Proces-Mbajtës
Noora Aarnio

Këshillë Ligjore:

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim ndaj këtij vendimi nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda 15 ditëve pas pranimit të së njëjtit.